



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-4945/21 datë:24.02.2021



Npi – 01/59 datë: 02.03.2021

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 02.03.2021, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I M B L E D H J E S Ë -II- T Ë K O M I T E T I T P Ë R K O M U N I T E T E

E mbajtur më: 02.03.2021 (e martë) në ora 14.00 h. në sallën e Kuvendit Nr.01

Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit për Komunitete: znj.Fatmire Ferati, znj.Diarta Vishesella, z.Muhamet Ademaj, z.Ruzhdi Brahimi, dhe z.Arton Demiri, kanë marrë pjesë edhe: Nga Zyra për Komunitete dhe Kthim, shefi i zyrës z.Ibrahim Demiri, Nga zyra për Informim z.Shëpëtim Gashi. Në mungesë të Kryesuesit të KPK-së z.Rahman Kadrija, mbledhjen e hapi Zëvendës Kryesuesja e Komitetit znj.Fatmire Ferati e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më: 26.01.2021,
2. Vlerësimi i gjendjes së përgjithëshme të komuniteteve, bazuar në vizitat e realizuara më herët,
3. Planifikimi i takimeve me MKK-në, dhe OJQ-të lidhur me mbështetjen për çështjet e evidentuara nga Komiteti për Komunitete,
4. Informatë për aktivitetet mujore të ZKKK-së,
5. Të ndryshme.

Zëvendës Kryesuesja, znj.Fatmire Ferati; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi Rendin e Ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më: 21.12.2020

Zëvendës Kryesuesja, znj.Fatmire Ferati; Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 21.12.2020.**

Pika 2

Vlerësimi i gjendjes së përgjithëshme të komuniteteve, bazuar në vizitat e realizuara më herët
Zëvendës Kryesuesja, znj.Fatmire Ferati; Fillimisht njoftoi Komitetin me vizitat e bëra te disa familje në gjendje më të vështirë sociale, dhe nxjerri përfundimin se në bashkëpunim me Zyrën

për Komunitete, janë bërë punë shumë të mira, disa familjeve u janë ndërtuar shtëpitë e banimit dhe pritet që edhe disa të ndërtohen dhe disa tjera në përfundim e sipër. Në vazhdim hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Muhamet Ademaj; Përshëndetje, edhe ne si KPK-ë por edhe ZKKK-ja kemi dhënë kontribut në përmirësimin e kushteve të jetesës për komunitetet pakicë në komunën tonë. Sipas meje gjendja e tanishme e komuniteteve është e mirë. I kemi vizituar disa familje dhe kemi pa se disa prej tyre i kanë kushtet më mirë e disa më keq. Unë e falënderoj ZKKK-në për angazhimin që ka treguar sidomos në fushën e banimit dhe strehimit. Siguria është e barabartë njësoj për të gjithë pa dallime. Po ashtu mua më gëzon fakti që fëmijët e komuniteteve pakicë po shkojnë në shkollë.

znj.Diarta Vishesella; Përshëndetje, edhe unë kam qenë në grup për të vizituar këto familje të komunitetit pakicë dhe kam vërejtë se gjendja e tyre socio-ekonomike është relativisht e mirë. Normalisht që kërkohet një mbështetje e vazhdueshme për rastet që janë më të rënda.

z.Arton Demiri; Përshëndetje, edhe unë mund të them se gjendja e komunitetit Rom është e mirë, por kemi pak problem me ujë të pijes, sepse nuk po furnizohemi nga ujësjellësi. Këtë problem e kemi paraqitur edhe më parë edhe në Komitet por edhe te kompania e ujësjellësit, dhe tani po shpresoj se do të rregullohet.

z.Ruzhdi Brahimi; Përshëndetje, unë mendoj se gjendja nuk është aq e mirë. Ne kemi njerëz me sëmundje kronike, që nuk kanë mundësi për me i siguruar ilaçet. Kemi po ashtu një Nënë me sëmundje të kancerit në kokë, e cila është në kushte të vështira ekonomike. Unë apeloj te Komuna që me e ndihmuar këtë rast aq sa ka mundësi.

Zëvendës Kryesuesja, znj.Fatmire Ferati; Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, është në gjendje që të ofrojë ndihma për raste të tilla por nevojitet që të bëhet edhe formalisht një kërkesë. Unë mendoj se ka barna të mjaftueshme pa pagesë për disa lloje të sëmundjeve, për sa u përket skamnorëve me sëmundje të rënda.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Përshëndetje, ju informoj se në komunën e Shtimes kemi gjithësejt 160 familje të komuniteteve Ashkali dhe Rom. Për të gjitha ne kemi krijuar një databazë me të dhënat kryesore. 1 persona janë me aftësi të kufizuara. 64 familje kanë anëtarë të familje me sëmundje kronike.

z.Muhamet Ademaj; Po ndërlidhem me Ibrahimin, meqenëse e paskeni një databazë a mund të na tregoni se sa prej tyre janë të punësuar në sektorin privat e sa në atë publik?

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Sa i përket punësimit, kemi një numër të ndryshueshëm prej 15 deri 30 varësisht, nga momenti sepse ka shumë prej tyre që janë të punësuar periodikisht. Sa i përket punëtorëve nga diaspora ne nuk kemi shënime. Tani për momentin janë 22 persona nga komuniteti pakicë duke përfshi edhe të vetëpunësuarit. Kemi 53 raste që marrin Asistencë Sociale. 51 raste marrin pension të pleqërisë.

Zëvendës Kryesuesja, znj.Fatmire Ferati; Unë mendoj se ka nevojë për vizita të tilla edhe më shpesh, për me u vërtetuar se deri ku janë realizuar ndërtimi dhe meremetimi i shtëpive për banim.

Pika 3

Planifikimi i takimeve me MKK-në, dhe OJQ-të lidhur me mbështetjen për çështjet e evidentuara nga Komiteti për Komunitete

Zëvendës Kryesuesja, znj.Fatmire Ferati; Unë paraprakisht ja kaloj fjalën z.Ibrahim Demirit, për të na e shpjeguar aspektin e planifikimit të takimeve me Ministrinë, me qëllim që me e pasë më të qartë mënyrën se si duhet përgatitur dokumentacionin për konkurrim në ndonjë projekt.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Sa i përket organizimit të takimeve unë rekomandoj që mos të lidhemi për datat, për arsye se tani së shpejti pritet që të formohet Qeveria e re, prandaj edhe ne do të presim pak që ta shohim se si do të shkojnë gjërat. Për momentin ne i kemi ftuar të rinjtë që të konkurrojnë në një program të organizuar nga OJQ-ë “Vois of Roma” ku përfitimet

pritet që të jenë deri në 150€, konsiderojmë se shuma është e vogël por më mirë pak se hiq. Nëse ka ndonjë pyetje unë do të përpiqem të jap përgjigje.

Pika 4

Informatë për aktivitetet mujore të ZKKK-së

Zëvendës Kryesuesja, znj.Fatmire Ferati; Për prezantimin e kësaj pike fjalën po ja kaloj Ibrahim Demirit, ndoshta do të na jep disa të dhëna më të detajuara për sa i përket pandemisë, te komuniteti pakicë sepse disa informata veq u dhanë nga Ibrahim në pikat paraprake.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Fillimisht ju njoftoj se është shënuar dita e flamurit të komunitetit Ashkali 15 Shkurti, me disa aktivitete, dhe ka kaluar mirë. Për sa i përket Pandemisë te komunitetet pakicë nuk ka pasë raste të deklaruara që kanë qenë të infektuara me virusin KOVID19, rrjedhimisht edhe nuk ka pas raste të vdekjeve. Ne kemi gjetë forma që secila familje është ndihmuar me pako emërgjente me gjëra ushqimore dhe të tjera. Informatën e kemi të shkruar dhe mund ta lexoni, (shih dokumentin).

Pika 5

Të ndryshme

Zëvendës Kryesuesja, znj.Fatmire Ferati; Hapi diskutimin për këtë pikë.


z.Arton demiri; Unë e falënderoj z.Ibrahim Demirin për angazhimin e tijë, pork am një kërkesë nga grupi i fëmijëve që janë të interesuar që ta mësojnë gjuhën angleze. Gjithësejt janë të interesuar rreth 20 fëmijë, nga komuniteti Rom janë 4 fëmijë dhe të tjerët janë nga komuniteti Ashkali. Këta janë në gjendje edhe të participojnë me nga 5 euro. Nëse keni mundësi me gjetë ndonjë donator për këtë projekt do të ishte e mirëseardhur.

z.Ruzhdi Brahimi; Sa i përket sektorit të bujqësisë, fshatrat e rrafshit siç janë Vojnovci e Gjyrvovci merren më shumë me bujqësi, ndërsa Shtimja sa e di unë merren me 10 %, mirëpo unë po kërkoj që sektori i bujqësisë në Komunën e Shtimes me na ndihmuar, me farë dhe me pleh, sepse shumica e fshatarëve nuk kanë mundësi me i siguruar për me e mbjellë tokën e tyre. Mendoj se Komuna duhet me bërë diçka për mos me lënë tokën batall.

Zëvendës Kryesuesja, znj.Fatmire Ferati; Është mirë që këtë kërkesë me e përcjellë edhe te sektori i bujqësisë, dhe me e shikuar mundësinë se si dhe çka munden me ndihmuar.

Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Zëvendës Kryesuesja, znj.Fatmire Ferati mbledhjen e përfundoi në ora 14.58 h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Zv.Kryesuesja e Komitetit
Fatmire Ferati

